

URDHËR
Nr.71, datë 20.5.2009

**PËR MARRJEN E DISA MASAVE MBËSHTETËSE, PËR MBARËVAJTJEN E
PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, 2009**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës

URDHËROJ:

1. Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve (AVA) të vihet në ruajtje 24 orë, me shërbim policor, nga data 26 maj deri më 31 korrik 2009.

2. Vënie në ruajtje 24 orë, me shërbim policor, gjatë periudhës 2 qershor – 22 korrik 2009, të ndërtesave, që do të jenë qendra të vlerësimit të testeve të nxënësve, në provimet e Maturës Shtetërore, 2009, si më poshtë vijon:

- a) Ndërtesa e shkollës “Sabaudin Gabrani”, Tiranë;
- b) Ndërtesa e shkollës “Qemal Stafa”, Elbasan;
- c) Ndërtesa e shkollës “Jordan Misja”, Shkodër;
- ç) Ndërtesa e shkollës “Naim Frashëri”, Fier.

3. Ministria e Brendshme të marrë masat për shoqërimin e transportimit të të gjitha materialeve të provimit, në të gjitha shkollat, në katër qendrat e përmendura në pikën 2 të këtij urdhri, në mjediset e caktuara, për këtë qëllim.

4. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OSSH-sh.a., të marrin të gjitha masat, për të garantuar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të institucioneve të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij urdhri, për periudhën respektive.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OSSH-sh.a., për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha